



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

| | | | |
|--|-------------------------------------|-------------------------------|-------------------------------|
| Pranimi / Dorezimi Priljevo/Prodato Received/Delivered | 18.12.2020 | 0 | viti god year |
| Organ /Institucija Org./Unit | Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No. | Shtojta Prilog Appendix | Sasia Kolicina Quantity |
| SKAMSHCK | 3212/2020 | | 112 |



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.342/2020

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave i përbërë nga: Arben Mehmeti –kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Eshref Shabani -anëtarë, si dhe Sabile Avdyli-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.342/2020 të datës 05.11.2020 të parashtruar nga ankuesi [REDACTED] me adresë banimi Rruga "Dëshmorët e Kombit" p.nr Vushtrri, kundër organit të punësimit Akademia e Kosovës për Siguri Publike në Vushtrri, në çështjen juridike "kërkesë nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim më datën 18.12.2020, mori këtë

V E N D I M

Hedhet Poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.342/2020 e datës 05.11.2020, e parashtruar nga ankuesi [REDACTED].

A r s y e t i m

Ankuesi [REDACTED], i punësuar në vendin e punës "Zyrtar i Lartë për Trajnime dhe Zhvillim" në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike në Vushtrri, me datën 05.11.2020 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 2445/2020 kundër Hartimit të Raportit të Sigurimit i Cilësisë dhe vlerësimit të publikuar në faqen zyrtare me datën 12.10.2020, lidhur me "Trajnimin Menaxhimi i vijës së parë".

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 11.11.2020 ka përcjell tek organi i punësimit kërkesën për përgjigje në ankesë. Akademia e Kosovës për Siguri Publike në Vushtrri me datën 23.11.2020 ka dërguar në Këshill shkresat e lëndës faqe 1/6.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, me qëllim të rishqyrtimit të ankesës së ankuesit, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollit 2445/2020 të datës 05.11.2020 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Raporti i Vlerësimit i datës 05.10.2020; Raporti i vlerësimit të trajnimit "Menaxhimi i vijës së parë" i datës 25.09.2020; Trajnimi "Menaxhimi i Vijës së Parë" i datës 12.07.2019; Komentet e bëra nga



pjesëmarrësit e kursit; Vendim për zgjedhjen e Qeverisë së Republikës së Kosovës me Nr.07-V-014 më datë 03.06.2020; E-mail i datës 12.10.2020; Vendim i datës 03.07.2020 me numër protokolli 71 dhe Përgjigje në ankesë e datës 23.11.2020 bashkë me shkresat e lëndës faqe 1/6.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës të dërguara si nga ankuesi ashtu edhe nga organi i punësimit ka konstatuar se ankesa e ankuesit [REDAKTUAR], është e palejuar, *sepse*:

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka shqyrtuar pretendimin ankimor të ankuesit, i cili pretendon se Raporti i Sigurimit për Cilësi dhe Vlerësim me Nnr.DSC-R-01/2020, i hartuar me datën 05.10.2020 është bërë në kundërshtim me dispozitat ligjore që rregullojnë këtë çështje. Kolegji për shqyrtimin e ankesave, bazuar në shkresat e lëndës konstatoj se në çështjen juridike kontestuese mungon legjitimiteti juridik i ankueses/palës, për faktin se hartimi i Raportit të Sigurimit për cilësi dhe Vlerësim i datës 05.10.2020, nuk ka prodhuar ndonjë pasojë juridike lidhur me të drejtat dhe interesat juridike të ankuesit, respektivisht nuk është cenuar ndonjë e drejtë apo interes juridik i ankuesit që do të përbënte shkak të arsyeshëm ligjore që ankuesi të parashtronte ankesë ashtu siç parashihet me dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përkatësisht nenin 124 i cili përcakton se: *pala ka të drejtë të ushtrojë mjetet juridike administrative ndaj çdo veprimi apo mosveprimi administrativ, nëse pretendon se të drejtat apo interesat e saj juridike cenohen nga ky veprim apo mosveprim, dhe nenin 24 paragrafin 3 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë. u thuhet "Nëpunësi civil ka të drejtë të paraqesë ankesë drejtpërdrejt në KPMSHC për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto, që burojnë nga marrëdhënia e Shërbimit Civil sipas këtij ligj*

Andaj, bazuar në këto rrethana, e në mbështetje të 18 paragrafi 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe nenin 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji për shqyrtimin e ankesave, vendosi që ankesa e parashtruar nga ankuesi [REDAKTUAR] i të hedhet poshtë si e pa lejuar.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIQËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.342/2020, 18.12.2020

Sabile AVDYLI

Sabile Avdyli
Procesmbajtëse

Arben MEHMETI

Arben Mehmeti
Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet

- Ankuesit, [REDAKTUAR]
- Drejtorit të Përgjithshëm të Akademisë së Kosovës për Siguri Publike;;
- Udhëheqësit të Personelit në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike dhe
- Arkivit të KPMSHC-ë